



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 24.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.04.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i shtratit të Lumit Krena - Faza finale", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1984- 5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-026-511, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "JOOS & KRASNIQI - BAZE" sh.p.k., e dt.18.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit Krena - Faza finale", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1984- 5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-026-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 18.03.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 18.03.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik "JOOS & KRASNIQI - BAZE" sh.p.k. me dt.18.04.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i shtratit të Lumit Krena - Faza finale", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1984- 5-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-026-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 24.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- **Numri i punëtorëve të paktën — 40 (katër dhjete):**

Kjo kërkesë nuk paraqet kufizim të panevojshëm sepse është kërkuar minimumi 40 (katërdhjetë punëtor) po ashtu duke marr parasysh vëllimin e punëve dhe afatin e realizimit të gjitha punëve 12 muaj, është e domosdoshme që të ketë staf të caktuar për ekzekutimin sa me te mire të punimeve. Pra, ky konstatim është i pa bazuar.

- **Kufizimi i përvojës vetëm pas diplomimit:**

Caktimi i përvojës së punës pas diplomimit është e domosdoshme sepse kerkohet staf profesional qe do te thote se eshte e domosdoshme pervoja e punes pas diplomimit, pra ky konstatim është i pa bazuar.

- **Kundërshtimi ndaj Përsëritjes së Kërkesës në Pikat (C) dhe (D):**

Duke marr parasysh vëllimin e punëve dhe natyrën e realizimit të gjitha punëve qe kane te bejne me hidrotekniken është e domosdoshme që të ketë ne staf minimum 2 Inxhinier te Ndertimtarise Hidro siq jane kerkuar ne dosje te tenderit. Pra konstatimi eshte i pabazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gütaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
